

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

KRYETARI I KOMUNËS
Presednik Opštine – Municipal Mayor

**LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT,
Z. SMAJL LATIFI
NGA DATA 03.02.2025 DERI MË 07.02.2025**

NR.	EMRI I VENDIMIT	NR. I PROTOKOLLIT
1.	Vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: "Servisimi i aparateve për shuarjen e zjarreve".	NRP-02-5254-2025
2.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referenës për aktivitetin e prokurimit: "Shërbimet e zhvendosjes me marimangë dhe të bllokimit të automjeteve".	NRP-02-5256-2025
3.	Vendim për punë shtesë të menaxherit dhe mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë për projektin "Ndërtimi dhe renovimi i QMF-ve dhe AMF-ve".	NRP-02-5257-2025
4.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë të menaxherit të kontratës: "Ndërtimi i rrugës me katër korsi nga Rahoveci në Xërxë-Lot1"	NRP-02-5258-2025
5.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave: "Vendosja e GPS-ve në veturat zyrtare".	NRP-02-5262-2025
6.	Vendim për shfuqizimin e urdhëresës për shpalljen e tenderit: "Furnizimi me pajisje me inventarë të shkollave"	NRP-02-5264-2025
7.	Vendim për caktimin e Grupit Punues për Hartimin e Rregullores dhe planit të veprimit për Transparencë të Komunës së Rahovecit.	NRP-02-5266-2025
8.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë të menaxherit të kontratës: "Furnizimi me letër për fotokopje"	NRP-02-5267-2025
9.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë të menaxherit të kontratës: "Mbikëqyrja e investimeve kapitale në Komunën e Rahovecit"	NRP-02-5268-2025
10.	Vendim për miratimin e kërkesës momentale për: "Mbulimin e shpenzimeve"	NRP-02-5272-2025

11.	Vendim për ndërprerjen e kontratës me titull: “Ndërtimi i rrugëve lokale në Komunën e Rahovecit-Lot2”	NRP-02-5275-2025
------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Orahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIK / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 5254 Nr. i faq./Br. str./No. pg 28
Data/Datum/Date 03 / 02 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të prokurimit publik, nenit 37 i Ligjit Nr.05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për prokurimin publik, nenit 63 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: **“Servisimi i aparateve për shuarjen e zjarreve”** me Nr. Prokurimi: 623-25-396-1-3-6 dhe Numër të brendshëm: 623-25-006-2-3-6, të datës 3.2.2025, në përbërje prej:
 - 1.1. Vjollca Berisha, kryesuese;
 - 1.2. Enise Dina, anëtare;
 - 1.3. Veton Kabashi, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të tenderit për projektin: **“Servisimi i aparateve për shuarjen e zjarreve”**.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


U dërgohet:

1. Anëtarëve të komisionit,
2. Zyrës së Prokurimit, dhe
3. Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011”), nenit 19 paragrafi 19.16 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: “Shërbimet e zhvendosjes me merimangë dhe të bllokimit të automjeteve”

1. Masar Vuçitërna, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Inspektor i Komunikacionit, në Drejtorinë për Inspektim, **emërohet** person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: “Shërbimet e zhvendosjes me merimangë dhe të bllokimit të automjeteve”.
2. Personi përgjegjës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka për detyrë që të bëjë hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.
3. Përgjegjësitë e personit për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, janë:
 - 3.1. Në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomikë, në përputhje me nenin 28 Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe akteve nënligjore (legjislacionit dytësor);
 - 3.2. Në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë;

- 3.3. Të cilat nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, një procesi të hollësishëm, ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë, ose ndonjë prodhimi.
4. Personi përgjegjës obligohet që të hartojë specifikimet teknike / termat e referencës deri më datë 10.2.2025.
 5. Personi përgjegjës obligohet që, së bashku me specifikimet teknike / termat e referencës, të dorëzojë edhe deklaratën në betim, të nënshkruar te Njësia e Prokurimit.
 6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Masar Vuçitërna,*
- *Drejtoria për Shërbime Publike,*
- *Njësia e Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 5266 Nr. i faq./Br.str./No.pg 29

Data/Datum/Date 06 / 02 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Rregullores dhe Planin e Veprimit për Transparencë të Komunës së Rahovecit

- Caktohet** Grupi Punues për hartimin e Rregullores dhe Planin e Veprimit për Transparencë të Komunës së Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1 Blerta Gashi, kryesuese
 - 1.2 Skender Hamza, anëtar
 - 1.3 Dafina Gashi, anëtare
 - 1.4 Mirsad Shala, anëtar
 - 1.5 Vjollca Gurgule, anëtare
 - 1.6 Ekrem Bytyqi, anëtar
 - 1.7 Vlora Nazifi-Gashi, anëtare
 - 1.8 Senad Mullavda, anëtar
 - 1.9 Sylejman Daka, anëtar
- Grupi punues ka për detyrë që të hartojë Rregulloren dhe Planin e Veprimit për Transparencë të Komunës së Rahovecit.
- Obligohet Grupi Punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
- Grupi Punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Grupit Punues për hartimin e rregullores dhe Planin e Veprimit për Transparencë të Komunës së Rahovecit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues, dhe
- Arkivit



Smajl Latifi
Kryetari i Komunës



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 63, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:


V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për punë të paparapara e menaxherit të projektit dhe mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë e datës: 14.5.2024, për projektin “**Ndërtimi dhe renovimi i QMF-ve dhe AMF-ve - Ritenderim**” me Nr. të Prokurimit 623-23-6893-5-2-1 dhe Nr. të Brendshëm 623-23-030-5-2-1 në shumën prej 25,302.80€ (njëzet e pesë mijë e treqind e dy euro e tetëdhjetë cent).
2. Ky vendim merret, pasi që është konstatuar nga mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë dhe menaxheri i kontratës së projektit dhe verifikimit të gjendjes në terren, se projekti është në fazën përfundimtare dhe për t’u funksionalizuar është e nevojshme që të kryhen punët e paparapara.
3. Obligohet Sektori i Prokurimit që t’i ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zhvillimin e procedurave sipas ligjeve dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Menaxheri i Projektit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Zyrës së Prokurimit,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Menaxherit të Projektit,
- Mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë, dhe
- Arkivit.





Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: “Ndërtimi i rrugës me katër korsi nga Rahoveci në Xërxë – Lot 1 - Ritenderim”, me numër të kontratës: 623-24-8684-5-1-1/C648, si në vijim:
 - 1.1. “P.M.N.” Sh.p.k me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Zenun Tolaj, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Përparim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funkcionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës

nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
 - 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblenjen;
 - 4.4. Pas pranimit të urdhërblenjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblenjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
 - 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
 - 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
 - 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
 - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
 - 4.14. Të japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
 - 4.15. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:
 - 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
 6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- **Menaxheri i kontratës,**
- **Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,**
- **Spektori i Prokurimit, dhe**
- **Arkivi.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No. 5262 Nr. i faq./Br.str./No.pg. 29

Data/Datum/Date 05/02/25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

- 1. Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Vendosja e GPS-ve në veturat zyrtare”, me Nr. prokurimi: 623-25-465-2-3-6 dhe Nr. të brendshëm 623-25-002-2-3-6 të datës: 05.02.2025, në këtë përbërje:
 - 1.1.** Faik Thaqi, kryesues
 - 1.2.** Enise Dina, anëtare
 - 1.3.** Bahrije Çmega, anëtare
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Vendosja e GPS-ve në veturat zyrtare”, me Nr. prokurimi: 623-25-465-2-3-6 dhe Nr. të brendshëm 623-25-002-2-3-6 të datës: 05.02.2025.
3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.


Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 44, nenit 53 paragrafi 1 dhe 3 dhe nenit 57 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative të datës 25.05.2016 dhe nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e urdhëresës Nr. Prot. 5221 e datës 30.1.2025 dhe Vendimit me nr. prot. 5219 të datës 30.1.2025

Shfuqizohen:

1. Urdhëresa me Nr. Prot. 5221 e datës 30.1.2025 e Zyrës së Prokurimit për shpalljen e tenderit: “Furnizimi me pajisje me inventarë të shkollave”, sipas parallogarisë në vlerën e parashikuar prej **35,000.00€ (tridhjetë e pesë mijë euro)**.
2. Vendimi për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi me pajisje për inventarë të shkollave”.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Prokurimit, Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit

Arsyetim

Kryetari i Komunës ka dhënë urdhëresë me Nr. Prot. 5221 më datë 30.1.2025 me të cilën është urdhëruar Zyra e Prokurimit që të shpallë tenderin “Furnizimi me pajisje me inventarë të shkollave”, në vlerën e parashikuar prej 35,000.00€ (tridhjetë e pesë mijë euro).

Pas konsultimit me Drejtorinë për Arsim dhe Zyrën e Prokurimit është konstatuar se ekziston kontrata me AQP-në për projektin “Furnizimi me pajisje me inventarë të shkollave”, kështu që nuk ka nevojë të zhvillohet procedura e prokurimit për projektin në fjalë dhe, për këtë arsye, është i domosdoshëm shfuqizimi i urdhëresës së cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- Zyra e Prokurimit,
- Drejtoria për Arsim,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahoвац/Municipality Rahovec / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KRYETARI I KOMUNËS – PRESIDNIK OPŠTINE – MUNICIPAL MAYOR

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 5266 Nr. i faq./Br.str./No.pg 29

Data/Datum/Date 06 / 02 / 25

RAHOVEC / ORAHOVA.C

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Rregullores dhe Planin e Veprimit për Transparencë të Komunës së Rahovecit

- Caktohet** Grupi Punues për hartimin e Rregullores dhe Planin e Veprimit për Transparencë të Komunës së Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1 Blerta Gashi, kryesuese
 - 1.2 Skender Hamza, anëtar
 - 1.3 Dafina Gashi, anëtare
 - 1.4 Mirsad Shala, anëtar
 - 1.5 Vjollca Gurgule, anëtare
 - 1.6 Ekrem Bytyqi, anëtar
 - 1.7 Vlora Nazifi-Gashi, anëtare
 - 1.8 Senad Mullavda, anëtar
 - 1.9 Sylejman Daka, anëtar
- Grupi punues ka për detyrë që të hartojë Rregulloren dhe Planin e Veprimit për Transparencë të Komunës së Rahovecit.
- Obligohet Grupi Punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
- Grupi Punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Grupit Punues për hartimin e rregullores dhe Planin e Veprimit për Transparencë të Komunës së Rahovecit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues, dhe
- Arkivit





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr. i Dëmit/No. of the Decision: 5267
Data/Datum/Date: 06 / 02 / 25

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: “Furnizim me letër për fotokopje - Lot 2 – Nivel Lokal”, me numër prokurimit: UA/2016-24-3284-1-1-1 dhe numër të kontratës: UA/2016-24-3284-1-1-1/C484, si në vijim:
 - 1.1. Qamil Sylka, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Depoist në Drejtorinë për Administratë, **CAKTOHET** menaxher i kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Besnik Hoti, Drejtor i Drejtorisë për Administratë, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funkcionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës

brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
 - 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblenjen;
 - 4.4. Pas pranimit të urdhërblenjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblenjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
 - 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
 - 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
 - 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
 - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
 - 4.14. Të japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
 - 4.15. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:
- 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- **Menaxheri i kontratës,**
- **Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,**
- **Spektori i Prokurimit,**
- **AQP-së, dhe**
- **Arkivi.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – **Municipal Mayor**



Nr./Br./No. 5268 Nr. i faq./Br.str./No. pg 29

Data/Datum/Date 06/02/25

00. ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, , nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M


Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: “Mbikëqyrja e investimeve kapitale në Komunën e Rahovecit” me numër të kontratës 623-23-7605-2-2-1/C502, si në vijim:
 - 1.1. Muharem Morina, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zyrtar për Rini, në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** menaxher i kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Albnor Mullabazi, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njofimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës

- brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";
- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
 - 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblenjen;
 - 4.4. Pas pranimit të urdhërblenjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblenjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
 - 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
 - 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
 - 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
 - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
 - 4.14. Të japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
 - 4.15. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:
 - 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
 6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/5070 i datës 5.12.2024.
 7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- ***Menaxheri i kontratës,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,***
- ***Spektori i Prokurimit, dhe***
- ***Arkivi.***

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 21, paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2, të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, me Nr.1427, të datës 28.4.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e z. [REDACTED] nga Rahoveci, me Nr. Prot. 356 të datës 3.2.2025, për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro), për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe për blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

[REDACTED] uan nga sëmundja e rëndë, i cili ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e tij. Shërimi i sëmundjes për të lartpërmendurin është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të.

Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave kanë kosto të lartë financiare, e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes së tij, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- [REDACTED] Rahoveci,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 5275 Nr. i faq./Br.str./No.pg 30
Data/Datum/Date 07 / 02 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenit 72 të Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, rekomandimit të Menaxherit të Projektit të datës 06.02.2025 për ndërprerjen e kontratës me titull: “Ndërtimi i rrugëve lokale në Komunën e Rahovecit - Lot 2” me nr. të prokurimit 623-20-3607-5-1-1 dhe nr. të brendshëm 623-20-033-5-1-1, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanëshme me titull “Ndërtimi i rrugëve lokale në Komunën e Rahovecit - Lot 2”

1. **Miratohet** kërkesa e menaxherit të projektit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanëshme me titull “Ndërtimi i rrugëve lokale në Komunën e Rahovecit - Lot 2” me nr. të prokurimit 623-20-3607-5-1-1 dhe nr. të brendshëm 623-20-033-5-1-1.
2. Ndërprerja e kontratës me marrëveshje të dyanëshme sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet për shkak të ngjarjes së shkaktuar nga forca madhore, që është shkaktuar pas datës kur kontrata ka hyrë në fuqi.
3. Obligohet Zyra e Prokurimit që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme konform dispozitave ligjore në fuqi për ndërprerjen e kontratës sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

Pas zhvillimit të të gjitha procedurave të prokurimit, Komuna e Rahovecit (në vazhdim Autoriteti Kontraktues), ka nënshkruar Kontratë publike kornizë me “Gashi Ing” Sh.p.k. me adresë në Suharekë, të cilën e përfaqëson Enver Gashi (në vazhdim Kontraktuesi), me titull “Ndërtimi i rrugëve lokale në Komunën e Rahovecit - Lot 2” me nr. të prokurimit 623-20-3607-5-1-1 dhe nr. të brendshëm 623-20-033-5-1-1 me Nr. Prot. 4037 të datës 06.10.2020.

Pas nënshkrimit të kontratës Autoriteti Kontraktues ka kryer punët sipas kushteve të parapara në kontratë.

Mirëpo, pas paraqitjes së Pandemisë COVID-19, situata ka ndryshuar, sepse artikujt të cilat janë objekt i punimeve sipas kësaj kontrate kanë pësuar ndryshime të mëdha në çmimin e furnizimit në treg në masën 65%.

Për këtë arsye, Kontraktuesi, ka parashtruar kërkesë me datë 06.02.2025, tek menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës, të cilët janë caktuar me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ, ndërprerjen e kontratës me titull: “Ndërtimi i rrugëve lokale në Komunën e Rahovecit - Lot 2” me nr. të prokurimit 623-20-3607-5-1-1 dhe nr. të brendshëm 623-20-033-5-1-1, me arsyetimin, se çmimet e produkteve nga momenti i nënshkrimit të kontratës në vitin 2020, kanë pësuar rritje të mëdha në vitet në vijim në masën prej 65%, dhe me këtë rast është e pamundur kryerja e punimeve sipas kontratës.

Pas kësaj, Menaxheri i kontratës me datë 06.02.2025, i është drejtuar Kryetarit të Komunës me kërkesë/rekomandim me për ndërprerjen e kontratës me titull “Ndërtimi i rrugëve lokale në Komunën e Rahovecit - Lot 2” me nr. të prokurimit 623-20-3607-5-1-1 dhe nr. të brendshëm 623-20-033-5-1-1, sipas kërkesës së arsyetuar të operatorit ekonomik.

Për këtë arsye, pas kërkesës së pranuar të Kontraktuesit të datës 06.02.2025 si dhe rekomandimit të menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të kontratës të datës 06.02.2025 për ndërprerjen e kontratës me titull “Ndërtimi i rrugëve lokale në Komunën e Rahovecit - Lot 2” me nr. të prokurimit 623-20-3607-5-1-1 dhe nr. të brendshëm 623-20-033-5-1-1, për shkak të rritjes së vazhdueshme të çmimeve të produkteve bazë për ndërtim në bursa ndërkombëtare poashtu edhe në Republikën e Kosovës, pas paraqitjes së Pandemisë COVID-19, si dhe duke u bazuar në nenin 38 të kësaj kontrate në të është e paraparë “forca madhore” e cila është shkaktuar pas datës kur kontrata ka hyrë në fuqi.

Pas administrimit të të gjitha provave, Kryetari i Komunës ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kontratës me Nr. Prot. 4037 të datës 06.10.2020 me titull “Ndërtimi i rrugëve lokale në Komunën e Rahovecit - Lot 2” me nr. të prokurimit 623-20-3607-5-1-1 dhe nr. të brendshëm 623-20-033-5-1-1.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- **Zyra e Prokurimit,**
- **Menaxheri i Projektit,**
- **Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i menaxherit të projektit, dhe**
- **Arkivi.**

